

Fakte mbi Aktivitetin Filantropik 2015

Partnerët Shqipëri punon për promovimin e filantropisë në Shqipëri prej vitit 2011. Duke marrë në konsideratë informacionet e pakta në këtë fushë, në vitin 2011 Partnerët Shqipëri kreu studimin **“Sipërmarrja dhe Filantropia”** për të krijuar një kuptim më të qartë të shkallës dhe natyrës së kauzave shoqërore të cilat mbështeten prej komunitetit të biznesit në Shqipëri. Përkrah tij Partnerët Shqipëri kreu dhe studimin mbi zhvillimin e filantropisë në Shqipëri **“Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri”**, që trajton këtë veprimtari, figurat kryesore dhe aktivitetin e tyre filantropik brenda dhe jashtë vendit, nga shekulli i XIX e deri në ditët e sotme.

Për të promovuar dhe mbështetur zhvillimin e kësaj traditë të hershme dhe me vlera, Partnerët Shqipëri organizon tashmë prej pesë vitesh ceremoninë **“Çmimi i Filantropisë”**, duke shprehur mirënjohjen dhe falenderimin për individët, familjet dhe bizneset që kontribuojnë për përmirësimin e cilësisë së jetës në vend. Vlerësimi dhe stimulimi i një aktiviteti të tillë mbetet i rëndësishëm për dimensionin human dhe ekonomik që ai mbart.


Spektori i biznesit luan midis të tjerëve aktorë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e iniciativave që adresojnë probleme të mprehta sociale, ekonomike dhe mjedisore. Në këtë funksion, Partnerët Shqipëri ka vendosur një partneritet të ngushtë me sektorin e biznesit në mbështetje të bizneseve të reja sociale në fushën e industrisë së gjelbërt. Qysh prej vitit 2013 Partnerët Shqipëri organizon konkursin vjetor **“Ide të Gjelbërta”** si pjesë e të cilit mbështeten sipërmarrje që promovojnë përfshirjen sociale, integrimin dhe punësimin, nëpërmjet shfrytëzimit të burimeve lokale e ringjalljes së traditave, duke ndjekur një përjasje miqësore ndaj mjedisit. Risia qëndron në bashkëpunimin dhe krijimin e një fondi investimi të përbashkët të krijuar nga dhurime të bizneseve dhe institucioneve filantropike private, lokale dhe ndërkombëtare në mbështetje të bizneseve të reja të gjelbërta. Automatikisht, idetë fituese konkurrojnë në nivel Ballkanik në konkursit **“Filantropia për Ide të Gjelbërta”** organizuar nga Rockefeller Brothers Fund.

Ky raport pasqyron aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë vitit 2015 i sjellë në mënyrë të sintetizuar nga Partnerët Shqipëri, bazuar në monitorimin ditor dhe **raportimin e rregullt mujor publik**. Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Monitorimi ka në bazë të tij hulumtimin e mediave, përfshi ato sociale si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Media është mjeti kryesor për promovimin e fushatave ndërgjegjësuese dhe raportimin e dhurimeve të kryera, me 116 raste nga 217 të evidentuara gjatë vitit 2015. Është vënë re se një rol të rëndësishëm ka luajtur edhe media sociale përveç asaj të printuar dhe elektronike. Ndërkohë, në rend të dytë vijnë faqet zyrtare të internetit të institucioneve publike, nëpërmjet të cilave janë promovuar dhe raportuar 101 raste dhurimi.

Vlera e Dhurimeve sipas Natyrës




Për vitin 2015 vlera totale e dhurimit të konstatuar në nivel vendi është 585,992,469 Lekë, ku përfshihen të gjitha natyrat e dhurimit (p.sh. monetare, mallra/produkte, shërbime dhe punë vullnetare¹). Dhurimi monetar zë vendin e parë në natyrën e dhurimeve të kryera me 55% të vëllimit total të dhurimit, i ndjekur nga dhurimi në mallra e produkte.

Muaji gusht ka qënë muaji me vlerën më të lartë të dhurimeve gjatë vitit 2015, me një vlerë prej 294,002,000 Lekë, ndërkohë që muaji korrik ka qënë muaji me vlerën më të ulët të dhurimeve me 725,000 Lekë.


¹ shërbimi i ofruar nga një individ apo grup individësh pa pagesë

Numri i Dhurimeve sipas Natyrës së Dhuruesit



Përsa i përket dhurimeve, sektori i **biznesit** zë vendin e parë me 72 dhurime ose 33%, i ndjekur nga dhurimet **Individuale** me 65 raste ose 30%, 41 raste nga sektori i **Organizatave Jo-fitimprurëse (OJF)** ose 19% dhe **Institucionet Publike**² me 39 raste ose 18%.


Vlera e Dhurimit përkundrejt Numrit të Dhuruesve



Për vitin 2015 vendin e parë me vlerën më të lartë të dhurimit e zënë **Institucionet Publike** me 444,607,760 Lekë ose 39 dhurime, 67,859,909 Lekë **OJF** ose 41 dhurime, 58,232,686 Lekë **Biznesi** ose 72 dhurime dhe 15,292,114 Lekë ose 65 dhurime **individuale**.

² Institucione Publike në nivel qendror dhe vendor, Institucione Ndërkombëtare dhe Komunitetet Fetare

Natyrat e Përfituesit




Përgjatë vitin 2015 **fëmijët** zënë vendin e parë të përfitimit të dhurimeve me 40%, e ndjekur nga **Publiku i gjerë**³ me 30%, 12 % **të moshuarit**, 9% **Institucionet Publike**, 5% **Gra**, dhe 1% **OJF**, **Komuniteti Rom**, **Biznesi** dhe **Komuniteti LGBT**.

Në rastin e Institucioneve Publike dhe OJF vërehen dy natyra përfitimi: (i) e para është kur dhurimi shkon drejtpërdrejt për ta dhe (ii) e dyta kur dhurimi shkon tek ta për tu kanalizuar më pas tek përfituesi përfundimtar. Në 117 dhurime për Institucionet Publike vetëm 7 kanë shkuar drejtpërdrejt për institucionin dhe 110 të tjerat për tu kanalizuar tek përfitues të tjerë, ndërsa OJF në 5 dhurime, 2 kanë shkuar për përfitim të drejtpërdrejtë dhe 3 për tu shpërndarë tek përfituesit përfundimtar.

³ Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatëkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës


Numri i Dhurimeve sipas Natyrës



Për vitin 2015 duket se 81% e rasteve të dhurimit janë kryer në formën e të mirave material (***mallra / produkte***), 14% e rasteve janë dhurime ***monetare***, 4% e rasteve ***shërbime*** dhe 1 % e rasteve në ***punë vullnetare***.

Muaji shkurt ka qënë muaji me rastet më të shpeshta të evidentuara nga PSH dhe ka patur një vlerë dhurimi prej 232,925,831 Lekë.


Fushat e Dhurimit




Ndihma ekonomike dhe lehtësimi i varfërisë përbën fushën me dhurimin më të lartë përgjatë vitin 2015. Janë konstatuar 159 raste (72%), ku pjesa më e madhe është dhuruar për institucionet që kujdesen për fëmijët, gratë dhe moshën e tretë. 27 raste (12%) janë dhuruar për ***Fatëkeqësitë natyrore***, ku përmendim përmbytjet që ndodhën në zonën e Fierit dhe Vlorës

në muajin shkurt. Në mbështetje të fushës së **Edukimit** janë dhuruar pajisje të tilla si kompiutera, skaner, printer dhe libra për shkolla, universitete dhe institucione të tjera. Në këtë fushë janë konstatuar 21 raste (10%). Fusha e Artit/Kulturës, Shëndetësisë dhe Mjedisit përbëjnë tre fusha të tjera mbështetje, përkatësisht 7 raste (3%) për fushën e **Artit/Kulturës**, 5 raste (2%) për fushën e **Shëndetësisë** dhe 2 raste (1%) për fushën e **Mjedisit**. Në këto fusha përmendim dhurimet në mbështetje të Festivalit Ndërkombëtar të Kitarës, pajisje të ndryshme mjeksore dhe aktivite për promovimin dhe përmirësimin e mjedisit.

Shtrirja Gjeografike e Dhuruesve



Shtrirja Gjeografike e Përfituesve




Për vitin 2015, baza e dhuruesve është nga qyteti i **Tiranës** me 73% të dhurimeve, i ndjekur nga qyteti i **Durrësit** me 6%, **Elbasani** dhe **Diaspora** me 5%, **Shkodra** me 3%, qyteti i **Fierit** dhe **Vlorës** me 2% dhe **Korça**, **Saranda**, **Lushnje** dhe **Poliçani** me 1%.

Për tu vlerësuar janë edhe dhuruesit nga diaspora, respektivisht institucione apo individë nga Gjermania, Turqia, Presheva dhe nga qyteti i Londrës, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre gjatë situatës së vështirë të përmytjeve në muajin shkurt.

Përsa i përket përfituesve, vendin e parë e zë përsëri qyteti i **Tiranës** me 56%, i ndjekur nga qyteti i **Fierit** me 12%, **Vlora** me 11%, **Shkodra** dhe **Durrësi** me 6%, **Elbasani** me 2% dhe **Berati**, **Korça**, **Poliçani**, **Lushnje**, **Shijak**, **Tetovë** dhe **Ulqin** me 1%.

Kanalet e Dhurimit



Gjatë hulumtimit është vënë re se në pjesën më të madhe të rasteve dhurimi kanalizohet nëpërmjet Institucioneve Publike për tu shpërndarë më pas tek përfituesi.

Në rastet e pakta kur dhurimet kanë shkuar direkt tek përfituesi kanë qënë gjatë fatkeqësive natyrore apo kur donatori ka patur dëshirë ta njoh personalisht përfituesin.

Gjatë monitorimit është konstatuar se shpesh donatorët preferojnë që shuma e dhuruar të mos bëhet publike. Në raste të tilla PSh i është dashur të kontaktoj drejtpërdrejtë me ta për të evidentuar masën e dhurimit.

Gjithashtu ka raste kur vetë donatorët preferojnë të mbesin anonim dhe kjo ndodh më shpesh kur ata janë individë apo dhurimi është kanalizuar nëpërmjet institucioneve të tjera.